



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE**

**PROJEKTVENDIM**

NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_/\_\_\_/2026

**PËR  
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË  
BASHKIAKE, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, e nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; ligjit nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, Vendimit nr.103 datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime ne Vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesem 2026-2028”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Policisë Bashkiake dhe Drejtoria e Buxhetit, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

**TË VENDOSË:**

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake të Bashkisë së Durrësit, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion	Shtesë për kushte të veçanta pune
1	Drejtor Drejtorie	1	123.000	
2	Përgjegjës Sektori	1	87.200	
3	Specialist	1/2	80.000	
4	Inspektor i Policisë Bashkiake	-	72.300	4.000
5	Punonjës i Policisë Bashkiake	-	66.000	4.000

- Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar, për numrat rendorë 1,2 dhe 3 të jepet në masën:
  - i. 0.6 % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - ii. 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - iii. 1 (një) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar për numrat rendorë 4 dhe 5 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.
- Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për cdo grup diplome është si më poshtë vijon:

















Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i shkencave. Master i arteve. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000 lekë
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000 lekë
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000 lekë

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2026 dhe do të përballohen nga fondi rezervë për rritjen e pagave planifikuar në buxhetin e vitit 2026.
3. Vendimi nr.96 datë 28.10.2024 , i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake Durrës shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Policisë Bashkiake, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

#### GRUPI PËR MENAXHIMIN STRATEGJIK NË BASHKINË DURRËS

Emiriana Sako	Kryetar	Kryetar i Bashkisë	
Gentian Kallmi	anëtar	Zëvendëskryetar	
Elio Jani	"	Zëvendëskryetar	
Egert Hoxha	"	Zëvendëskryetar	
Almiva Llaçi	"	Drejtor i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë	
Alneida Rroshi	"	Drejtor i Drejtorisë Ligjore	
Ina Ferra	"	Drejtor i Drejtorisë Ekonomike	
Roni Shqiopa	"	Drejtor i Drejtorisë së Takasave dhe Tarifave Vendore	
Alda Zyferi	"	Drejtor i Drejtorisë së Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik	
Valbona Qiriako	"	Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit	
Brunilda Gripshi	"	Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore	
Ana Hoxha	"	Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit	
Lorenc Smajli	"	Drejtor i Drejtorisë së Turizmit	
Migena Muhaj	"	Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare	
Diola Xhango	"	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale	
Xhulio Llazo	"	Drejtor i Drejtorisë së Informatikës dhe Dixhitalizimit	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës

RELACION

PËR  
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE  
TË POLICISË BASHKIAKE, DURRËS

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, e nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; ligjit nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, Vendimit nr.103 datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime ne Vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesem 2026-2028”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Buxhetit kanë hartuar nivelet e reja të pagave për punonjësit e aparatit të Drejtorisë së Policisë Bashkiake.

Ky relacion ka si qëllim realizimin e indeksimit dhe rritjes së pagave për punonjësit e aparatit të Drejtorisë së Policisë Bashkiake në përputhje me legjislacionin për pagat.

1. Paga bruto mujore për punonjësit e Policisë Bashkiake (përfshijtur policët dhe inspektorin) përbëhet nga këta element:
  - Paga për pozicion pune, që shpërblen vlerën relative të cdo pozicioni pune.
  - Paga për pozicion ndryshon sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion në lekë Ishte	Paga për pozicion në lekë bëhet
1	Drejtor i Policisë bashkiake	1	120.000	123.000
2	Përgjegjës Sektori në Policinë Bashkiake	1	85.000	87.200
3	Specialist në Policinë Bashkiake	1,2,3	75.000	80.000

- **Shtesa e nivelit të kualifikimit**, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës.

Referuar lidhjes nr.9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.503, datë 01.08.2024, vlera e pagës së grupit, për cdo nivel të studimeve universitare është sipas tabelës së mëposhtme:

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (Lekë/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i Shkencave. Master i Arteve; Master Profesional të përfiturar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike; Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14,000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master Profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12,000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor.)	10,000

- **Shtesa për vjetërsi në punë**, e cila do të jepet në masën:
  - 0.6 (zero pikë gjashtë) % pas çdo viti pune, pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - 1 (një) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi. Përrjashtohen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Sikurse e cituam dhe më lart vjetërsia nuk do të llogaritet 2% mbi pagën e grupit (diplomën) mbas çdo viti pune deri në 25 vjet, kurse tashmë shtesa për vjetërsi do të llogaritet mbi pagën e pozicionit, sipas mënyrës që cituam më lart dhe arrin deri në 30 vite pune.

2. Për policët bashkiakë, paga bazë ndryshon si më poshtë. Ata do të përfitojnë një shtesë për kushte punë në masën 4000 lekë në muaj.

Paga e tyre paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Paga për pozicion	Vjetërsia	Shtesë për kushte të veçanta pune
1	Inspektor i Policisë Bashkiake	72.300	1%	4.000
2	Punonjës i Policisë Bashkiake	66.000	1%	4.000

Shtesa për vjetërsi në punë për ta jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

**Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak Durrës të vendosë:**

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Policisë Bashkiake Durrës, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion	Shtesë për kushte të veçanta pune
1	Drejtor i Policisë bashkiake	1	123.000	
2	Përgjegjës Sektori në Policinë Bashkiake	1	87.200	
3	Specialist në Policinë Bashkiake	1/2	80.000	
4	Inspektor i Policisë Bashkiake	-	72.300	4.000
5	Polici bashkiak	-	66.000	4.000

- a. Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar, për numrat rendorë 1,2 dhe 3 të jepet në masën :
  - i. 0.6 ( zero pikë gjashtë) % pas çdo viti pune, për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - ii. 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - iii. 1 (një) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- b. Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar për numrat rendorë 4 dhe 5 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për cdo grup diplome është si më poshtë vijon:

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (Lekë/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i Shkencave. Master i Arteve; Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike; Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14,000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master Profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12,000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor).	10,000

1. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2026 dhe do të përballohen nga fondi rezervë për rritjen e pagave planifikuar ne buxhetin e vitit 2026.
2. Vendimi nr.96 datë 28.10.2024 , i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Durrës”, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Policisë Bashkiake, Drejtorja e Buxhetit dhe Drejtorja Ekonomike.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore

Brunilda Gripshaj



Drejtorja Policisë Bashkiake

Realdo Vrioni



Drejtorja e Buxhetit

Valbona Qiriako



Drejtorja Ekonomike

Ina Ferra

